

**Mbt: Intervistë e ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal, Sadri Ferati**

**T: Decentralizimi në veri shtyhet për më vonë**

**Nt: “Decentralizimi i veriut është problem, sepse atje kemi një ambient të pasigurt me deficit të hatashëm të sundimit të ligjit”, ka thënë ministri Ferati**

**Bukurie Bajraliu**

**Prishtinë, 21 maj** – I filluar shumë vjet më parë, procesi i decentralizimit vazhdon të jetë sfidë për Qeverinë, e në veçanti për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, të cilën e udhëheq ministri i LDK-së, Sadri Ferati. Ky proces i vlerësuar nga udhëheqësit vendës si kompromis i dhimbshëm për Kosovën edhe për një kohë nuk do të mund të zbatohet në veriun e Mitrovicës, derisa atje të mos sundojë ligji. Këtë e thotë në një intervistë për “Kohën Ditore” ministri Sadri Ferati. Ky i fundit ndonëse paralajmëron se në veri do të hapet zyra e ekipit përgatitor për krijimin e Komunës së Mitrovicës, ai në të njëjtën kohë thotë se kjo do të bëhet kur institucionet e rendit do të ofrojnë siguri për gjithë atë pjesë. Ministri Ferati tregon se ndarja e kufirit në mes Prishtinës dhe Graçanicës do të marrë edhe pak kohë, dhe se ua ka tërhequr vërejtjen komunave të reja serbe që t’i rishqyrtojnë statutet e tyre e në to të përfshihet emërtimi Republika e Kosovës. Ai ka paralajmëruar se Kosova gjatë vitit të ardhshëm do ketë më shumë se 38 komuna sa ka aktualisht.

**Deri në çfarë faze ka arritur procesi i decentralizimit?**

Ferati: Procesi i decentralizimit nuk ishte i lehtë, mirëpo pas një mobilizimi të përgjithshëm për ta trajtuar drejt këtë projekt dhe me mbështetje të grupit ndërministror dhe në koordinim me ICO-në dhe në përkrahje të shoqërisë kosovare u pa se falë këtij, procesi i

decentrazimit e shënoi një etapë të veten të suksesshme. Kjo etapë është bartja e kompetencave nga komunat, mbajtja e zgjedhjeve, instalimi i komunave dhe tani jemi në prag të fazës së dytë dhe jemi në krijim e sipër të Komunës së Parteshit, kurse çështja e Mitrovicës mbetet për një kohë më të gjatë.

A vazhdon të jetë problem bindja e komunitetit serb që të marrë pjesë në këtë proces?

Ferati: Kjo nuk ka qenë e lehtë. Fillimisht kemi kontaktuar individë dhe problemi më i madh ka qenë që t'i kemi në kontakt qytetarët. Të jem i sigurtë, pastaj gjithçka ka shkuar lehtë, sepse ne ofrojmë një projekt me kompetenca të gjëra, autonomi të fuqishme si të menaxhojnë me pasuritë e tyre dhe ta përmirësojnë kualitetin e jetës. Projekti jonë ofron një perspektivë të përbashkët dhe pikërisht ky kualitet i projektit e ka lehtësuar punën dhe gjithçka ka shkuar deri këtu.

A keni identifikuar personat që do të kontaktoni edhe për veriun?

Ferati: Për veriun kemi bërë një test provues me organizimin e dy konferencave ku kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve serbë dhe grupeve të tjera të interesit dhe kemi parë se qytetarët atje janë shumë të përfunduar me këtë proces. Ne kemi thënë edhe herët e tjerë se nëse do të krijoheshin parakushtet që të vazhdojmë projektin tonë atje ne do ta vazhdonim, mirëpo veriun është problem sepse atje kemi një ambient të pasigurt me deficit të hatashëm të sundimit të ligjit dhe pikërisht duke dashur t'i ruajmë ata njerëz, të cilët ne i kemi atje, ne nuk jemi të gatshëm që të dalim në atë anë dhe të organizojmë takime direkte me qytetarët, sepse qytetari atje është shumë i rrezikuar.

Kur pritet të ndodhin këto takime me qytetarë?

Ditore: Nuk do ta kisha kufizuar përgjigjen, sepse sikur ta kisha ditur kur EULEX-i do të ngrejë kapacitete të fuqishme në atë anë, kur Policia e Kosovës do të forcohet, kur do të instalohen gjykatat, pastaj kur do të rregullohen pikat doganore, me një fjalë se kur do të vendoset ligji, atëherë lehtë do ta prognozoja përgjigjen se kur do ta realizonim projektin tonë atje kështu që janë shumë arsyeje që unë nuk dua të spekuloj me afatin.

Sipas kësaj që e thatë ju, po del që decentralizimi në veri nuk varet vetëm nga institucionet vendëse?

Ferati: Decentralizimi atje nuk varet vetëm nga MAPL, por nga sundimi i ligjit. Pastaj përveç kompetencave për krijimin e komunave të reja në Leposaviq, Zveçan dhe Zubin-Potok ne duhet të krijojmë edhe mekanizma të tjerë që projektin tonë ta bëjnë më interesant, sepse nuk është dobia e projektit tonë që vetëm të krijohet komuna në pjesën veriore të Mitrovicës dhe të fuqizohen institucionet lokale në atë anë, por që ata të përfitojnë nga grantet e qeverisë nga partnerët donatorë. Krahas kësaj do të shkojë linja e zhvillimit socio-ekonomik dhe ndërtimit të një perspektive evropiane misioni i të cilës është edhe hapja e shtëpisë evropiane e udhëhequr nga ambasadori Giffon. Kjo ka për qëllim që sa më tepër ta promovoj idenë e perspektivës evropiane, EULEX-i, Policia e Kosovës dhe të tjerët ta bëjnë sundimin e ligjit, kurse ne nëpërmes fondeve të donatorëve të punojmë në krijimin e fondit socio-ekonomik dhe si përgjegjësi e ngushtë e MAPL-së që përmes ekipeve përgatitore atje të krijohet një ambient relaksues që do të çmohet barazia qytetare dhe të krijohet pastaj një besueshmëri se ne mund të shpallim zgjedhjet se do të ketë një strukturë politike administrative që do t'u shërbejë të gjithë qytetarëve pa dallime.

Çka ka bërë deri tash ekipi përgatitor për decentralizimin në veri?

Ferati: Ne kemi një ekip përgatitor atje. Tash e kemi përfunduar konkursin atje për të hapur një zyrë të MAPL-së, e cila do të ketë

5-6 persona. Është pak e rëndësishme se ku do të gjendet ajo zyrë, në veri ose në jug, se për këtë nuk kemi vendosur ende. Mirëpo kemi vendim që zyra e ekipit përgatitor do të jetë në veri dhe varësisht e shohim se ku do të na bie më lehtë, sepse me gjithë dëshirën për të punuar ne, në asnjë moment nuk ta abstragojmë gjendjen reale që është atje në terren dhe ne nuk do të dëshironim që njerëzit tanë t'i gjuajmë në cilëndo pjesë. Do të bëjmë vlerësime se në cilën zonë do të jetë më e lehtë puna e tyre.

Po a ka MAPL-ja strategji për strukturat paralele në veri?

Ferati: Realisht atje ekziston një improvizim që ekziston një komunë që nuk ka për qëllim fare që të ofrojë shërbime për qytetarë, por më tepër ka për qëllim të jetë një lloj përcuesi i politikës ditore të Beogradit dhe si e tillë jolegale dhe aspak e dobishme. Shihet se ata i kanë problemet e veta. Shihet se ata në maj do të mbajnë zgjedhje të jashtëzakonshme, këtë e bëjnë se ata nuk kanë bërë asgjë dhe këtu ekziston një esencë e që është interesimi i qytetarëve për të bashkëpunuar me neve për të krijuar një komunë legale dhe të fuqishme. Dhe kjo është një tendencë e Beogradit që ta vonojë procesin tonë e jo t'i ndihmojë qytetarët serbë në atë pjesë të cilët dëshirojnë ta ndryshojnë këtë gjendje sepse strukturat paralele e kanë pasur rastin për këtë, por kanë dështuar dhe qytetarët janë shumë të zhgënjyer. Mua me dhimbsen qytetarët e Komunës së Zubin-Potokut, Leposaviqit e Zveçanit se ata thonë që mirë, ne do të bashkëpunojmë me juve, por Beogradi do të na ndalë rrogat.

Cila është përgjigja juaj në këtë rast?

Ferati: Nuk kam përgjigje në këto raste, sepse ne akoma nuk kemi qasje fizike për ta krijuar një komunë ku qytetari i ka shërbimet dhe i thotë Beogradit të faleminderit për ndihmën që ma jep se kosovarët e kanë marrë shtetin në duart e tyre dhe jemi të barabartë

dhe ti urdhëro na ndihmo neve sikur që Tirana po i ndihmon Graçanicës.

Kthehemi sërish te komunat e reja. Cila është arsyeja që ato edhe pas gjashtë muajsh të themelimit janë duke punuar në shtëpi private?

Ferati: Momentalisht jemi në objekte të përkohshme për të cilat paguajmë qira. Kjo po ndodh se komunat nuk janë ndërtuar më herët, mirëpo ato do të bëhen. Komisioni Evropian së shpejti do të zgjedh kompaninë që do të fillojë ndërtimin e objekteve komunale në 5-6 komuna dhe tri prej tyre do të jenë: Graçanica, Kllokoti dhe Ranillugu.

A do të thotë kjo se objektet komunale do të jenë të gatshme në këtë vit?

Ferati: Ato do të fillojnë këtë vit, mirëpo nuk e besoj që një objekt shumë i madh dhe modern të përfundojë brenda këtij viti.

Dihet se Qeveria e Kosovës, i ka krijuar komunat e reja, mirëpo ato komuna në statutet e tyre as që e përmendin Republikën e Kosovës pjesë e të cilës janë. Madje kjo është vërejtur edhe në emblemat e tyre, siç ishte rasti me Komunën e Graçanicës. A keni kërkuar sqarime prej kryetarëve të atyre komunave?

Ferati: Jo vetëm tek Graçaniça, por kemi edhe raste të tjera. Ne kemi dërguar shkresa që emblemat e komunave të jenë konform ligjit. Graçanica e ka kthyer shkresën dhe ka treguar vullnetin që në mbledhjen e parë të Asamblesë Komunale që do të mbahet do ta rikthejë emblemën e komunës në shqyrtim dhe do të marrë vendim konform Ligjit për vetëqeverisje lokale.

Decentralizimi parasheh edhe ndarjen e kufijve komunalë, çka po ndodh në këtë drejtim?

Ferati: Është formuar komisioni përkatës nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, nga përfaqësuesit e komunës amë dhe nga përfaqësuesit e komunës së re për të gjitha rastet. Zonat kadastrale dihen në bazë të pakos dhe vetëm do të bëhet konstatimi formal dhe do të jepen të gjitha hartat për t'u konstatuar zyrtarisht dhe kjo tashmë është çështje e nënshkrimit të marrëveshjeve. Por vetëm te komuna e Graçanicës kjo nuk ka përfunduar ende se një zonë kadastrale duhet të pritët dhe këtu do të ketë punë, ndërsa të tjerat janë në rregull. Në Graçanicë gjendja duhet të konstatohet në terren dhe zyrtarët e dy komunave janë duke punuar në këtë drejtim.

A vazhdon të jetë edhe më tej decentralizimi kompromis i dhimbshëm për kosovarët?

Ferati: Mosqasja jonë fizike në gjithë territorin e Kosovës është e dhimbshme, mirëpo decentralizimi si proces nuk është i dhimbshëm. Për shembull në Maqedoni pas një konflikti që ishte u krijuan 120 komuna, mirëpo me kalimin e kohës kanë mbetur vetëm 80 komuna se e kanë parë që krijimi i komunave nuk i zgjidh problemet e qytetarëve nëse ajo nuk ofron shërbime. Ne e kemi politizuar këtë tepër, përndryshe definicioni është shumë i thjeshtë, një e drejtë që qytetari e gëzon në qendër i jepet mundësia ta realizojë në komunën e tij.

Ky proces e lejon Beogradin që t'i ndihmojë komunat serbe, si do t'i kontrolloni ju ato ndihma kur dihet se tash sa vite institucionet kosovare nuk kanë pasur qasje në ndihmat e ofruara nga Serbia?

Ferati: Kjo është gjendje jonormale, sepse po ndodh ajo që nuk duhet të ndodhë, sepse neve po na rrit ngarkesat, kurse qytetarëve po ua ndal perspektivën. Është e drejtë e çdo komune të Kosovës që të ketë relacione dhe partneritet me cilëndo komunë dhe ne si MAPL jemi të obliguar t'i kontrollojmë këto bashkëpunime në ato fusha ku ato janë përgjegjëse, ndërsa rrjedhja e ndihmës duhet të

shkojë përmes Thesarit të Kosovës. Ajo mund të marrë dhe të japë ndihmë, por me informimin e institucioneve qendrore.

A keni informacione që komunat serbe po financohen nga Beogradi?

Ferati: Nuk kemi informacione që ata kanë marrë, por kemi ankesa nga kryetarët e komunave serbe se investimet e deklaruara nga Qeveria serbe në këto komuna të reja nuk do të bëhen përmes tyre por përmes strukturave paralele që funksionojnë po në ato komuna.

A do të përfundojë decentralizimi vetëm me krijimin e këtyre komunave?

Ferati: Në përgjithësi kjo ka qenë faza e parë e decentralizimit dhe në vitin 2011 ne do t'ia bëjmë një analizë këtij procesi deri këtu, do të mësojmë atë që duhet të mësojmë, do të ndryshojmë atë që duhet të ndryshojmë, duke mos e prekur esencën, duke rregulluar më mirë procesin dhe pastaj procesi do të hapet për të gjithë qytetarët e Kosovës. Por do të jemi shumë të kujdesshëm që të mos krijojmë komuna sa për formë, por të krijojmë komuna që do të kenë kapacitet zhvillimi. Do të ketë standarde mbi të cilat do të ndërtohen dhe numri i komunave nuk do të jetë 38, ai do të shtohet dhe kjo është dëshmi e asaj që e kemi thënë se decentralizimi nuk është proces që i kushtohet vetëm një komuniteti. Ne kemi qenë të detyruar t'i bëjmë pesë plus një komunë, por askush nuk na ndalon neve t'i krijojmë edhe 50 komuna të tjera.

Zëri më i fuqishëm kundër decentralizimit vazhdon të jetë lëvizja “Vetëvendosje”. A ka të drejtë kjo lëvizje në vlerësimet e tyre për këtë proces?

Ferati: Jo vetëm “Vetëvendosja”, por të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës e shikojnë me interesim shumë të madh se si do të zhvillohen rrjedhat në veri dhe nuk ia zë të madhe as vetes

nëse e shikoj me dilema atë proces. Nëse ne tregojmë një sensibilizim se atje proceset nuk duhet të vonohen, Beogradi më në fund duhet ta kuptojë se nuk është e drejtë e tij, përkundrazi është vazhdim i një avazi të vjetër që ta përdorur qytetarin atje për qëllime politike të tij. Kështu që, nëse kjo është esenca, unë mendoj se ka të drejtë, sepse ne nuk i kemi ikur akoma rrezikut të Beogradit për ta çakorduar atë pjesë atje. Mirëpo dua të besoj se projekti jonë do të realizohet edhe në atë pjesë. Por ne akoma nuk po e shohim një qartësim të bashkësisë ndërkombëtare në raport me Beogradin lidhur me këtë çështje, ngase atje sa krijohet një ide që kemi një qeveri demokratike pas një jave përmes një deklaratë vërehet e kundërta.

Pse kryetarët e zgjedhur në zgjedhjet lokale të nëntorit të mbajtura edhe në Zubin-Potok, Zveçan dhe Leposaviq nuk mund t'i ushtrojnë pozitat e tyre?

Ferati: Nuk ka qenë e pritshme realisht që ato komuna të funksionojnë me 30 vota të gjitha të një komuniteti dhe nuk ka qenë kjo ambicia jonë që të krijohet një paralelizëm i paralelizmit që ekziston atje. Ideja jonë ka qenë që qytetarët të dalin në zgjedhje dhe ta instalojmë një strukturë kredibile e cila do të mund ta ndryshonte këtë situatë që është tash. Por unë do të them që atje nuk kemi pasur zgjedhje të lira në mungesë të sundimit të ligjit. Atje kemi pasur një automjet lëvizës për votime dhe ka qenë ofenduese. Ne kemi bërë një improvizim sa për t'u arsyetuar dhe kjo ka qenë shumë e dëmshme. Dhe, nëse nuk është bërë dje duhet ta bëjmë nesër dhe të sigurojmë vendvotime nëpër shkolla sikur e kemi bërë në gjithë Kosovën. Ne jemi të gatshëm që të mbajmë zgjedhje atje, por presimin ambient të sigurt të cilin duhet ta krijojë Policia dhe KFOR-i.